

# YOUNG

YOUTH PERSPECTIVES  
ON THE FUTURE  
OF KOSOVO

## KONFERENCA YOUNG/TË RINJTË PIKËPAMJET E RINISË PËR TË ARDHMEN E KOSOVËS

### RAPORT<sup>1</sup>

EULEX-i ka zotim afatgjatë për t'i ndihmuar autoriteteve të Kosovës të ndërtojnë institucione të qëndrueshme dhe të pavarura të sundimit të ligjit. Sundimi i ligjit varet shumë nga shkalla e përfshirjes së të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti të të rinjve. Nëse garantohet sistematikisht, përfshirja dhe përfaqësimi korrespondojnë me mirëqenien dhe prosperitetin e institucioneve demokratike, meqë institucionet përbëhen prej njerëzve.

Në mënyrë që sundimi i ligjit të ofrohet në praktikë për të gjithë, është jetike që pjesëtarët e komunitetit të kenë frymë të përbashkët të identitetit, besimit dhe përfaqësimit në drejtim të këtyre institucioneve dhe brenda tyre. Meqë rinia padryshim se përfaqëson të ardhmen e Kosovës, dëshirat, aspiratat dhe projektet e të rinjve janë të një rëndësie madhore. Në të vërtetë, askush nuk mund të përpiqet ta përmirësojë të ardhmen pa i marrë parasysh pikëpamjet dhe idetë e atyre që në kuptimin e plotë të fjalës e kanë të ardhmen në duart e tyre – rinisë. Më tej, meqë të rinjtë kanë nevojë dhe interesa specifike, ata kanë nevojë edhe për politika të shënjestruara si dhe për institucione – pikë së pari në sektorin e sundimit të ligjit – që mundësojnë pjesëmarrjen e tyre dhe që i përgjigjen kërkesave të tyre.

Roli i të rinjve është përcaktuar me Rezolutën e parë 2250 të KSOKB-së për rininë, paqen dhe sigurinë, e miratuar në vitin 2015, si dokument referimi, në të cilën theksohet roli i të rinjve si agjentë për paqe dhe siguri dhe përmes së cilës iu bëhet thirrje klasave

tona politike për ngritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete të parandalimit të konflikteve, por edhe në vendimmarrje në të gjitha nivelet. Së bashku me Rezolutën 1325 të KSOKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë, kjo përfaqëson udhërrëfyesin global për të siguruar që zëri i të rinjve dhe grave duhet të dëgjohet për trajtimin e sfidave të shekullit XXI.

Për të krijuar hapësira të dedikuara për zërat e rinisë kosovare, dhe për të mbështetur kuptimin gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës të avancimit të sundimit të ligjit, më 27 qershor 2019 EULEX-i organizoi konferencën "YOUNG/TË RINJTË", evenimenti i parë që është organizuar ndonjëherë nga Misioni që ka për fokus të rinjtë dhe pikëpamjet e tyre mbi të ardhmen e Kosovës.

Sa i përket sundimit të ligjit, në Kosovë janë miratuar ligje dhe rregullore që janë të avancuara dhe në pajtim me standardet dhe praktikën më të mira evropiane. Zbatimi, megjithatë, është konstatuar të jetë më problematik. Institucionet e Kosovës, si dhe organizatat mbështetëse, duhet të përqendrohet tek faza e zbatimit të ligjeve, duke siguruar që barazia zyrtare dhe të drejtat plotësisht të përkthehen në barazi praktike dhe në ushtrim të të drejtave. Çka është e rëndësishme, institucionet e Kosovës duhet të përshtatin progresin teknologjik. Nëse shfrytëzohet në mënyrën adekuate, digjitalizimi mund të hapë rrugë drejt angazhimit kuptimplotë me të rinjtë dhe të inkurajojë proaktivitetin.

<sup>1</sup> Ky dokument është përpilim i mendimeve dhe ideve të shprehura nga pjesëmarrësit e konferencës YOUNG/TË RINJTË, që u mbajt më 27 qershor 2019 në Prishtinë. Ky dokument nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e EULEX Kosova.

Sa i përket vet të rinjve, ata po ashtu e bartin përgjegjësinë kur është fjala për mirëqenien dhe funksionimin e mirë të institucioneve të Kosovës. Në këtë drejtim, vajzat dhe djemtë duhet të ngritin bashkëpunimin në përpjekjet e tyre për avokim, të demonstrojnë iniciativa vis-à-vis avancimit të komuniteteve të tyre dhe të marrin përgjegjësinë dhe detyrat e tyre qytetare si pjesëtarë aktivë të shoqërisë së Kosovës.

Pjesëmarrësit dhe panelistët e konferencës u ndanë në grupe punuese ku diskutuan rreth çështjeve të rëndësishme të të rinjve në sektorin e sundimit të ligjit, diskutuan rreth mënyrave në të cilat ata mund të promovojnë qytetari aktive, të qojnë tutje politika, të ndikojnë në proceset e vendimmarrjes, e të tjera. Këto grupe pasqyruan opinione dhe përvoja të vajzave dhe djemve të ri të cilët janë aktivisht të angazhuar në avokim, fuqizim, përfaqësim dhe ndërmarrësi të rinjtë në Kosovë. Ata dolën me propozime dhe konstatime sa i përket faktorëve të ndryshëm të rëndësishëm që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndikojnë në dimensione të ndryshme të sundimit të ligjit.

Propozimet dhe konstatimet e grupeve punuese u përqendruan tek çështjet si:

Përfshirja e aspektit gjinor dhe kuptimi ndërsektoral i diskriminimit duhet të promovohen në mënyrë sistematike, dhe më e rëndësishme, zërat që nuk janë mjaftë të përfaqësuar duhet të gjejnë vend në diskutimet politike. Promovimi i përfshirjes së komuniteteve të marginalizuara si personat me nevoja të veçanta, komuniteti LGBTI+, të cilët shpesh hasin në diskriminime në sektorë të ndryshëm. Zbatimi i ligjeve ekzistuese të avancuara në këtë sektor po ashtu është hap i domosdoshëm për arritjen e përfshirjes sociale të këtyre grupeve;

Rritja e përfaqësimit të të rinjve dhe e qytetarëve aktive nëpër institucione, posaçërisht në sektorin e sundimit të ligjit;

Fuqizimi dhe përfshirja e të rinjve në procese të vendimmarrjes drejt ndërtimit të institucioneve më transparente dhe llogaridhëse të sundimit të ligjit;

Digjitalizimi i institucioneve publike në masë të madhe rritë transparencën dhe llogaridhënien dhe në këtë mënyrë bënë avancimin e sundimit të ligjit. Institucionet duhet të marrin sfidën e ndërveprimit më sistematik dhe të drejtimit me qytetarë, duke eksploruar mundësi të reja të hapura nga progresi teknologjik. Me anë të shembujve, institucionet duhet të

shtojnë reagimin e tyre ndaj kontributeve dhe sugjerimeve të qytetarëve, si dhe praninë e tyre online.

65 profesionistët e ri, si mënyrë e bashkëpunimit i sugjeruan Misionit EULEX të rritë dukshmërinë dhe kontaktimin me anë të angazhimeve offline dhe online me të rinjtë në veçanti, për të promovuar perspektivat e sundimit të ligjit duke përdorur standardet dhe praktikat më të mira evropiane si modele jetike për t'i ndjekur.

